

VENDIM
Nr. 90, datë 29.6.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “HEC VLUSHE” SHPK, PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SAJ SI KOLATERAL PRANË BANKËS KOMBËTARE TREGTARE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika 1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 8 të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 89, datë 13.12.2006 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës me seri PV10P “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.6.2012, pasi shqyrtoi kërkesën për lënie peng të aseteve si kolateral nga shoqëria “Hec Vlushe” sh.p.k. pranë Bankës Kombëtare Tregtare, si dhe relacionin Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hec Vlushe” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2 emri dhe adresa e plotë e të licencuarit (janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korrekte).

- Neni 7, pika 1.3, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij (ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja).

- Neni 7, pika 2,3,4 dhe 5 (ky informacion është plotësuar tërësisht).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hec Vlushe” sh.p.k., për lënie peng si kolateral të 100% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani